

# PERMBLEDHJE JOTEKNIKE

## E VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

**Aktiviteti qe zhvillohet aktualisht : ID.3.1/e.** Përzierja e çimentos ose përdorimi i çimentos në masë të madhe por jo në sheshin e ndërtimit, përfshirë ambalazhimin dhe përzierjen e çimentos, grumbullimi i betonit dhe prodhimi i blloqeve të betonit dhe produkteve të tjera të çimentos, si dhe prodhimi i llaçit, kollës, gëlqeres (parafabrikateve, paletave, etj.) ID 3.11 Prodhimi dhe Fraksionimi i produkteve minerale jometalike

**Ndryshimi qe kerkohet eshte zgjerim i kordinatave dhe shtim i aktiviteti me ID 5.4/c. Rikuperim i mbetjeve jo të rrezikshme dhe ID 5.10/b Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme që nuk përmendet më lart. (Kapaciteti i barabartë me 50 ton/ditë ose më i madh se kaq.)**



**Vendodhja : Zona kadastrale 2105, Kashar , Tirane**

**Subjekti : PEPA GROUP shpk**

**Perfaqesues Ligjor me prokure Lulezim Pepa**

**Tirane 2025**

*Lulezim Pepa*  
**PEPA GROUP**  
Shpk  
NUIIS: L42015009L  
Tirana - Albania

## **PERMBAJTJA**

### **Hyrje**

- a) Pershkrim i shkurtër i mbulesës bimorë të sipërfaqes ku propozohet të zbatohet projekti
- b) Informacion për praninë e burimeve ujore në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të saj
- c) Një identifikim të ndikimeve të mundshme negative në mjedis të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, tokë, ujë, ajër.
- d) Një përshkrim të shkurtër për shkarkimet e mundshme në mjedis të tilla si , ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurmë, si dhe prodhimin e mbetjeve
- e) Informacion për kohezgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuar
- f) Të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësimore të ndikimit negativ në mjedis, që nënkupton distancën fizike nga vendodhja e projektit dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të
- g) Mundësinë e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësinë e kthimit të sipërfaqes të mjedisit të ndikuar në gjendjen e mëparshme, përfshirë edhe token bujqësore , si dhe kostot financiare të përafërta për rehabilitimin
- h) Masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis
- i) Ndikimet e mundshme në mjedisin nderkufitar ( nëse projekti ka natyrë të tillë)

## HYRJE

Shoqëria PEPA GROUP shpk është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me date 15.10.2014, numër NIPT : L42215009L, Zyra qendrore e shoqërisë: Autostrada Tirane Durres km 6, Zona Kadastrale nr.2105, Nr Pasurie 1168/13 , objekti aktivitetit “ Prodhim dhe shitje materiale ndertimi (beton) i te gjitha llojeve dhe markave , Impiantin e prodhimit te betonit, Ne prodhimin e industrise dhe te perpunimit te produkteve te industrise se kromit, te bakrit, te xehoreve dhe te mineraleve te tjera, ne industrine e prodhimi te material ndertimit etj “ dhe administrator Violeta Pepaj.

Raporti synon te jape nje informacion te detajuar dhe te besueshem lidhur me ndikimin mjedisor te projektit te propozuar ne perdorimin e tokes, efektet lidhur me ndikimet ne floren, faunen, burimet e ujit, shkarkimet ne toke, uje, si dhe çdo ndikim social ekonomik ne punesimin lokal, permiresimin e infrastruktures dhe ndikimeve te tjera te rendesishme mjedisore ose sociale, perfshin gjithashtu parashikimin dhe planifikimin e masave zbutese te ndikimeve te projektit ne mjedisin fizik dhe social me qellim permiresimin e cilesise dhe qendrueshmerise se mjedisit nepermjet :

- Marrjes ne konsiderate te çeshtjeve te mjedisit ne fazen e pergatitjes se projektit.
- Shqyrtimit te alternativave te ndryshme brenda projektit.
- Te jape nje gjendje sa me reale, nga pikepamja e ndikimit te aktivitetit mbi mjedisin human.
- Analizen e faktoreve pozitive e negative mjedisore, percaktimin e masave zbutese per reduktimin e ndikimeve negative.
- Nxjerrjes ne dukje dhe vleresimin cilesor te ndikimeve ne mjedis te projektit.
- Propozime te masave zbutese te ndikimit ne projekt.

Per kete problem u be mbikqyrja e terrenit ne te gjithë zonen, duke kryer vrojtme te ndryshme , si dhe te biodiversitetit.

Ne raport jepet statusi i territorit, korniza ligjore e tij, mjedisi biofizik, gjeologjia e rajonit, gjeologjia e zones, hidrogeologjia.

Mjedisi dhe mbrojtja e tij nuk eshte i rendesishem vetem per njerezit por eshte thelbesor dhe i nevojshem per te gjitha qeniet ne toke. Njerezit duhet te kuptojne se si perdorimi i burimeve mjedisore dhe perfitimet qe vijne nga ato te mos demtohen por te jete e mundur te perfitohet sot dhe ne te ardhmen.

Termi mjedis dhe burime natyrore perdoren shpesh por jo gjithmone me kuptimin e qarte qe i perkufizon . Burimet natyrore i referohen burimeve te tokes, ujerave siperfaqesore dhe nentokesore , ajrit qe rrethon token, çdo gje qe rritet ne toke apo det si dhe burimet qe gjenden nentoke si psh mineralet. Mjedisi eshte me gjithperfshires, çdo gje qe na rrethon.

Thjesht duke perdorur burimet natyrore ne rrezikojme ne mbiperdorimin dhe shterimin e tyre. Shterimi i burimeve natyrore eshte nje nga problemet thelbesor te çrregullimit te mjedisit. Ne te perfshihet shterimi i ujit, mineraleve perfshire dhe lendet fosile si dhe shume burime te tjera.

Çdo veprimtari e kryer nga njeriu shoqerohet edhe me impakt ne mjedis. Pra impakti mjedisor i referohet ndryshimit te mjedisit natyror nga aktiviteti njerezor.

Kemi dy tipe te impaktit mjedisor

- Shterimi i burimeve
- Ndotja

Ne menyre qe te shmangen keto probleme njerezimi duhet te mesoj se si te menaxhohen burimet natyrore ne menyre te qendrueshme. Pra zhvillimi i qendrueshem i burimeve natyrore nuk eshte gje

tjeter vecse perdorimi i tyre ne menyre ekonomike nga brezat e sotem per ti len keto burime te perdoren edhe nga brezat qe do te vijne.

Qendrueshmeria perfshin menaxhimin e gjithe perberesve dhe burimeve natyrore e njerezore me qellim qe te pasurohen me kalimin e kohes dhe te sigurohet nje mireqenie per te gjithe. Zhvillimi i qendrueshem nuk i pranon politikat te cilat cojne ne uljen e bazes prodhuese dhe lene gjeneratat e ardhshme me prespektiva me te ulta ( te varfera) dhe/ose rreziqe me te medha se te tonat. Teknologjite qe kontribuojne ne zhvillimin e qendrueshem perfshijne kontrollin e ndotjes, prodhimin e energjise se riciklueshme, rikuperim burimesh dhe riciklim, menaxhim burimesh dhe kerkime shkencore.

Problemet mjedisore ne vendin tone lidhen me ndotjen e ajrit ne qytetet kryesore , ndotja e ujit e cila vjen nga shkarkimi i ujerave te ndotura pa u trajtuar fillimisht dhe mbetjet urbane te cilat jo te gjitha depozitohen ne vendet e caktuara.

### **Qellimi i VNM- se**

Qellimi i hartimit te raportit te VNM-se eshte percaktimi i efekteve negative dhe pozitive te aktivitetit dhe masat e duhura per permiresimin dhe zvogelimin e ndikimeve ne mjedis si rezultat i **zhvillimit te projektit te prodhimit te betonit dhe te fraksionimit te inerteve si lende e pare ne industrine e ndertimit, grumbullimit dhe ruajtjes se perkohshme te mbetjeve dhe rikuperimit te mbetjeve te ndertimit.**

VNM nuk do te mbuloj çdo aspekt te nje efekti mjedisor te projektit, me te njejtin nivel detajesh. Theksi do te vihet ne ndikimet kryesore qe shkakton zhvillimi i aktivitetit.

Gjithashtu nje synim tjeter eshte te percaktoje e rekomandoje masat teknike- organizative per zbutjen e aneve negative qe mund te krijohen gjate zvillimit te aktivitetit dhe te jape informacion per vendim-marresit per pasojat mjedisore te aktiviteteve te propozuara.

### **Objektivat e VNM**

Objektivat e hartimit te VNM- se konsistojne ne evidentimin dhe reduktimin e ndikimeve ne mjedis dhe masat tekniko-organizative per nje zhvillim te qendrueshem te mjedisit, gjate kryerjes se aktivitetit deri ne perfundim te tij dhe rehabilitimin e hapesires te prekur nga aktiviteti, per nje mjedis te qendrueshem ne vitet pas ardhese.

Me kete studim informojme organet vendim-marres, mbi ndikimet ne mjedis dhe perfitimet e projektit te propozuar. Gjithashtu zhvillimin e qendrueshem duke siguruar qe zbatimi i projektit nuk prek burimet natyrore dhe funksionet ekologjike ose mireqenien, stilin e jetes dhe jetesen e komunitet si dhe te njerezve qe lidhen apo varen nga ky projekt ose veprimtari.

### **Objektivat e tjera te studimit te paraqitur jane.**

- Permiresimet mjedisore te zones ku zbatohet projekti dhe rreth saj.
- Perdorimin e burimeve natyrore ne menyren te qendrueshme ku respektohen dhe kerkesat e komunitetit te zones perreth.
- Identifikon masat e duhura per zvogelimin e ndikimeve te mundshme potenciale negative te projektit te zbatuar
- Lehteson informimin e organeve vendim-marrese, duke perfshire vendosjen e termave dhe kushteve mjedisore per zbatimin e projektit apo propozimit.
- Mbrojtjen e shendetit te njeriut.
- Parashikon dhe perjashton ndryshimet e pakthyeshme dhe demtimet serioze te mjedisit.

-Ruan dhe mbron burimet natyrore, peizazhet e natyres dhe komponentet perberes te ekosistemeve.

-Permireson aspektet sociale te projektit.

### **Pershkrim i permbledhur i kuadrit ligjor mjedisor dhe institucional qe lidhet me projektin**

Ne Shqiperi fillesat e legjislacionit mjedisor shfaqen ne vitin 1993 , vit ne te cilin u hartua plani i pare i veprimit ne fushen mjedisore, qe perben dokumentin e pare zyrtar shqiptar mbi politikat mjedisore ne vend. Ky plan veprimi kombetar parashikonte se qeveria duhet te krijojte kuadrin ligjor , ekonomik dhe institucional per zgjidhjen e ceshtjeve mjedisore. Periudhen nga ky vit deri ne miratimin e Kushtetutes ne vitin 1998 mund ta konsiderojme si etapan e pare te zhvillimit te se drejtes shqiptare te mjedisit. Mbas vitit 1998 e ne vijim eshte periudha e dyte e zhvillimit te se drejtes shqiptare te mjedisit, e cila ka si tipar kryesor prirjen e perafimit me legjislacionin e Bashkimit European per mjedisin. Kuadri ligjor mjedisor shqiptar eshte ne persosje dhe pasurim te vazhdueshem dhe zhvillimi i tij nuk i eshte len rasteies, por ka si model dhe drejtues legjislacionin european te mjedisit. Nisur nga permbajtja e neneve te Kushtetutes lidhur me fushen mjedisore mund te pohojme se fryma e Kushtetutes sone eshte ne perputhje me ate te shume kushtetutave te vendeve te tjera demokratike qe u kushtojne rendesi te nje niveli me te larte disa parimeve mjedisore, duke i ngritur ato ne nivelin e ligjit themelor te shtetit, sic jane e drejta per informimin e qytetareve dhe angazhimi e pergjegjesia per nje mjedis te pershtatshem per te jetuar jo vetem brezat e sotem por edhe ata ne te ardhmen.

- Ligji nr.52/2020 date 30.04.2020 per nje ndryshim ne ligjin nr. 10 448 date 14.07.2011 « Per Lejet e Mjedisit »
- Ligjnr.53/2020 date 30.04.2020 per nje ndryshim ne Ligji Nr.10 431,date 09.06.2011 “ Per Mbrojtjen e Mjedisit”
- VKM nr.686 date 29.7.2015 « Per miratimin e rregullave , te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis (VNM) dhe procedures se transferimit te vendimit e Deklarates Mjedisore »
- Ligji 128/2020 Per disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin nr. 10440 date 07.07.2011 « Per vleresimin e ndikimit ne mjedis » te ndryshuar
- VKM nr. 435 date 12.09.2015 « Per miratimin e normave te shkarkimeve ne ajer ne Republiken e Shqiperise »
- VKM nr. 575 date 24.06.2015 “Per miratimin e kerkesave per menaxhimin e mbetjeve inerte”
- VKM nr.419 date 25.6.2014 « Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipave A,B dhe C per transferimin e lejeve nga nje subject te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mjedisit si dhe rregullave te hollesishme per shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKLja.
- Vendim Nr. 247, datë 30.4.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”
- VKM nr. 229 date 23.04.2014 “ Per miratimin e rregullave per transferimin e mbetjeve jo te rrezikshme dhe te dokumentit te transferimit te mbetjeve jo te rrezikshme”.
- VKM nr.371 date 11.06.2014 ‘Per përcaktimin e rregullave per dorezimin e mbetjeve te rrezikshme dhe miratimin e dokumentit te dorezimit te mbetjeve te rrezikshme”
- VKM nr. 765 date 07.11.2012 “Per miratimin e rregullave per grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave te perdorura”
- Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”
- Ligj nr. 10266 date 15.04.2010 “Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja” per disa ndryshime dhe shtesa ne Ligjin nr. 8897 dt. 16.05.2002 “Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja”

- VKM. Nr 177, datë 31.03.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse”.
- VKM nr.204 date 30.06.2021 “Per miratimin e katalogut te mbetjeve”

## **PERSHKRIMI PROJEKTIT**

### **Qellimi i projektit**

Aktualisht shoqeria PEPA GROUP shpk zhvillon aktivitetin e impiantit te prodhimit te betonit dhe fraksionit te inerteve dhe kerkon te bej ndryshim te lejes ekzistuese qe disponon me PN-9476-10-2019 duke shtuar siperfaqen dhe aktivitetin me **ID 5.4/c. Rikuperim i mbetjeve jo të rrezikshme dhe ID 5.10/b Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme që nuk përmendet më lart. (Kapaciteti i barabartë me 50 ton/ditë ose më i madh se kaq.)**

**Per kete ndryshim shoqeria eshte pajisur me shkresen nga AKM nr.11258/1 prot date 30.10.2025 e cila njofton shoqerine PEPA GROUP shpk te vijoje me aplikimin per ndryshim te kushteve te lejes mjedisore.**

Pra qellimi i aktivitetit qe zhvillohet nga **shoqeria PEPA GROUP shpk** aktualisht eshte fraksionimi I inerteve dhe prodhimi I betonit si lende e pare ne industrine e ndertimit. Duke qen se shoqeria si objekt aktiviteti ka edhe ndertimin e objekteve civile, industriale , rrugeve te kategorive te ndryshme etj gjenerohen mbetje ndertimore te cilat kerkon ti grumbulloj, ruaj perkohesisht dhe rikuperoje permes frontos qe disponon. Mbetjet inerte do te rikuperohen nga pajisja e frontos ( karta teknologjike e te ciles kryen edhe funksionin e rikuperimit) ne menyre qe te riperdoren kryesisht si material mbushes ne ndertim.

### **Vendndodhja e objektit**

Aktiviteti do te zhvillohet ne zonen kadastrale nr.2105, Kashar, Tirane.

Kordinatat e vendodhjes ku do zhvillohet aktiviteti jane si meposhte:

Nr.	X (N)	Y (E)
1	4581452.57	4392928.58
2	4581457.54	4392910.44
3	4581426.87	4392898.88
4	4581448.36	4392832.47
5	4581688.50	4392920.88
6	4581659.60	4392999.11



## Pershkrimi Teknik

Shoqëria prej vitesh zhvillon aktivitetin e saj në fushën e ndërtimit, duke realizuar punime në ndërtimin e objekteve civile, industriale, rrugëve të reja, si edhe në rehabilitimin e atyre ekzistuese. Për nevojat e procesit të ndërtimit, shoqëria ka instaluar impiantin e betonit dhe një fronto për fraksionimin e inerteve që janë lende të para në prodhimin e betonit. Gjatë këtyre veprimtarive gjenerohen mbetje inerte dhe frontoja të instaluar, sipas kartës së saj teknologjike, ka gjithashtu funksionin e rikuperimit të këtyre mbetjeve. Me qëllim zhvillimin e mëtejshëm të këtij procesi dhe përputhjen me kërkesat ligjore në fuqi, shoqëria kërkon shtimin e **ID 5.4/c. Rikuperim i mbetjeve jo të rrezikshme dhe ID 5.10/b Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme që nuk përmendet më lart. (Kapaciteti i barabartë me 50 ton/ditë ose më i madh se kaq.)**

### - Impianti ekzistues për prodhimin e betonit

Impianti i prodhimit të betonit është i markës: Simem, Modeli: WETBETON 100, Autmatizimi: Sistem betoni, Matrikolla: WB.100.0.379, Viti i prodhimit: 2008, Kapaciteti i prodhimit 80-100 m<sup>3</sup>/ore.

Elementet kryesore të impiantit të betonit.


1. Bunkeri I magazinimit të agregateve
2. Bunkeri I peshimit të agregatit
3. Rripi I transportuesit nxjerrës
4. Rripi transportues
5. Kabina e kontrollit
6. Bunkeri I mbajtjes së agregateve
7. Bunkeri I mbajtjes së cimentos
8. Bunkeri I peshimit të ujit

9. Transportues me vidë të çimentos
10. Sillos I magazinimit te cimentos
11. Struktura mbajtese e sillosit
12. Mishelatori
13. Koni I shkarkimit
14. Përzierësi i binjakëzuar

Sekuena e operacioneve për një cikël prodhimi eshte :

- Kontrollohet që njësia e ujit të jetë nën presion.
- Fuqizimi i panelit elektrik dhe aktivizimi i qarkut të kontrollit.
- Komisionimi i kompresorit (impiantit përzierës) dhe pritje që të gjitha qarqet pneumatike të jenë nën presion.
- Doza e inerteve.
- Dozimin e çimentos.
- Futja 10-15% të ujit në mikserin e kamionit.
- Shkarkimi i agregateve në mikserin e kamionit.
- Shkarkimi i betonit në përzierësin e çimentos.
- Mbyllni dozimin e ujit

Lendet e para inerte do te sigurohen nga frontoja e cila do te kryej fraksionim te mineralit gur gelqeror por edhe nga subjekte te tjera te licensuara, cemento , additive gjithashtu do te sigurohen nga shoqeri te licensuara per prodhimin dhe tregtimin e tyre. Uji do te sigurohet nga pusi qe disponon shoqeria per te cilin eshte pajisur me leje per perdorim te burimit ujqor nentokesore nr.02/29 prot date 26.06.2023 nga Keshilli i Basenit ujqor Ishem.



Skeda teknologjike

- **Metodologjia e punes se frontos per fraksionimin e inerteve edhe per rikuperimin e mbetjeve inerte**

Frontoja eshte vendosur ne nje pozicion te tille ne terren ne menyre qe te mund te jete i aksesueshem dhe te mos pengoj punen ne impiantin e betonit apo aktivitetet e tjera.

Ne afersi te Frontose, do te pozicionohen dy eskavatore njeri me cekic dhe njeri me kove. Frontoja do te furnizohet me material inert (mbetje inerte) me permasa deri ne 10 cm, I cili I nenshtrohet procesit te fraksionimit/thyerjes/therrmimit/rikuperimit. Materiali per rikuperim i vene ne dispozicion duhet te pastrohet paraprakisht. Prandaj ai hapet ne sheshin e punes nga eskavatori dhe pastrohet nga materialet qe mund te hiqen me dore. Pasi eshte pastruar material i mbetjeve inerte per fraksionim do te hidhet ne Fronto nga Eskavatori, ne menyre te tille qe te mos krijohen pluhura te medha, duke minimizuar lartesine e hedhjes se materialit ne fronto, nga kova e eskavatorit. Ne qofte se material i ka hekura, ato terhiqen nga vet frontoja, per shkak te mekanizmit magnetik qe ka te instaluar. Materiali inert me vone kalon ne njesine e thyerjes/therrmimit, e cila eshte e graduuar ne dhembet e saj, qe material i inert i prodhur te jete ne permasat 40 mm. Agregati inert i fraksionuar/rikuperuar do te merret nga nje eskavator hidraulik me zinxhir, dhe do te ngarkohet ne kamionet e vene ne dispozicion, per transportin e materialit te prodhuar ne destinacionin e urdheruar. Cdo dite do te percaktohet sasia e prodhuar nga frontoja ne dite, me ane te nje formulari, i cili do te plotesohet nga personat e autorizuar per kontrollin e sasise se prodhuar, transportuar dhe firmosjen e formularit nga ana e kontrollorit dhe transportuesit.

**Sistemet kryesore te frontose jane**

- Ushqyesi
- Sistemi i thyerjes me nofulla
- Transportuesi I levizshem
- Sistem ndares magnetik dhe transportuesi anesor I tyre
- Paneli I kontrollit

Prodhimi ditor i Frontose eshte 650-700 m<sup>3</sup> agregat I prodhuar/10 ore pune ne dite.

Frontoja eshte e pajisur me kazan vibrues me kontrollues automatik per te rregulluar ushqyerjen e aparatit thyeres ne fronto.

***Qellimi i perdorimit te frontos eshte thermimi i inerteve malore te forte dhe mesatarisht te forte (ne rastet kur kryhet fraksionimi i inerteve te siguruara nga shoqeri te licensuara per shfrytezimin e gurit gelqeror) por edhe rikuperimi dhe fraksionimi i mbetjeve inerte , te cilat dalin nga prishja e objekteve ekzistuese por edhe ndertimi i objekteve te reja, ndertimi dhe sistemimi i rrugeve etj.***

Sistemi i thyerjes eshte i kontrollueshem per te ndryshuar madhesine e inerteve qe kerkohen ne dalje dhe ka nje kapacitet te madh daljeje. Frontoja me dimensioned qe ka eshte ideale per tu

instaluar ne ambjente ku nuk ka shume hapësira dhe është lehtësisht i cmontueshem për tu transportuar ne rast se do kërkohej instalimi ne vendodhje tjeter.

Theksojme se lenda e pare e inerteve malore per fraksionim sigurohet nga subjekte te licensuara per nxjerrjen e tyre, ndersa mbetjet inerte per rikuperim gjenerohen nga aktiviteti ne fushen e ndertimit qe ka shoqeria jone ( ndertim i objekteve civile, industriale, rrugeve urbane apo interurbane).

### **Udhezimet e sigurise per perdorimin e pajisjes**

Per nje perdorim te sigurt te pajisjes duhet te respektohen kushtet e meposhtme:

- Pajisja te perdoret vetem nga staf i trajnuar
- Manuali i perdorimit te kuptohet dhe te zbatohet nga i gjithe stafi
- Pajisja te vendoset ne funksion vetem pasi te jete ber kontrolli qe cdo gje eshte ne rregull
- Stafi qe do te perdor pajisjen duhet te jene te pajisur me veshje mbrojtese kapele pune, kufje per zhurmat dhe kepuce pune.
- Asnjeher nuk duhet te behen rregullimi apo pastrime gjate kohes qe pajisja eshte ne pune pa u fikur fillimisht
- Nuk lejohet perdorimi i pajisjes nen ndikimin e pijeve alkalike apo kushteve shendetesore jo te mira
- Nuk lejohet pirja e cigares ne afersi te rezervuarit te karburantit qe sherben per venien ne pune te frontos
- Nuk lejohet mbushja e rezervuarit me karburant te pajisjes gjate kohe qe eshte ne pune

Perpara venies ne perdorim te frontos behet kontrolli i kushteve mekanike , sigurohemi qe bunkeri ushqyes dhe rripat transportues jane te pastruara, behet kontrolli i nivelit te vajit ne motor dhe ne vibrues, me dore kontrollohet therrmuesi qe te rrotullohet lirshem( asnjeher nuk kryhet kjo procedure kur frontoja eshte ne gjendje pune).



*Foto te frontos*

#### - **Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme**

Mbetjet te cilat do te grumbullohen ne stacionin e transferimit jane mbetjet e ndertimit te cilat do i nenshtrohen dhe rikuperimit , sipas VKM Nr.402 date 30.06.2021 Per miratimin e Katalogut te mbetjeve jane mbetjet me kod 17, si dhe mbetjet urbane me kod 20 si leter dhe karton, qelq, dhera dhe gure, metale , plastike, mbetje nga pastrimi i rrugeve si dhe mbetjet me kod 16 01 03 goma jashte perdorimit ( keto mbetje gjenerohen nga nderrimi I gomave te mjeteve si kamiona , autobetoniere etj ne pronesi te shoqerise). Per mbetjet te cilat nuk do i nenshtrohen rikuperimit si leter dhe karton, qelq, metale, plastike shoqeria do te lidh kontrata me shoqeri te licensuara per riciklimin dhe trajtimin e metejshem te tyre.

Mbetjet e plastikave, qelqit, te metalit, mbetjet e betonit, tulla, tjegulla , dhera te gjeneruara nga operacionet per ndertimet civile te objekteve, rrugeve, urave, konstuksioneve b/a dhe metalike, perpunimi i metaleve, plastikave, etj, grumbullohen, ngarkohen ne kamionat 25 ton dhe do dergohen ne sheshin e magazinimit qe disponon subjekti ku do i nenshtrohen operacioneve të stacionit të transferimit per mbetje jo te rrezikshme dhe seleksionimit te tyre sipas kodeve perkatese, duke i magazinuar ne reparte dhe kontenier te vecante sipas rrymave prioritare te mbetjeve. Me pas mbetjet e metaleve dhe plastikave sipas rrymave specifike jane ne pritje te operacioneve per riciklimin perfundimtar te tyre nga operator te licensuar konform rregullave te legjislacionit mjedisor ne fuqi. Ne territorin ku do ushtrohet veprimtaria e magazinimit te plastikave, qelqit, te metalit, mbetjeve te ndertimit subjekti do instaloj nje peshore e cila do sherbej per peshimin e kamionave duke bere te mundur rregjistrimin e sasise se mbetjeve te grumbulluara dhe transportuara.

Procesi i grumbullimit dhe transportimit te mbetjeve, konsiston ne ngarkimin e mjeteve nepermjet vincit i cili eshte i inkorporuar ne mjetin e transportit, kamionat pasi ngarkohen mbulohen me mushama dhe behet pastrimi i gomave me qellim shmangien e ndotjes se rrugeve urbane te qytetit.

#### **Fazat kryesore te procesit**

Procesi qe kryhet perbehet nga fazat e tij te meposhtme:

- a) pranimi dhe magazinimi i mbetjeve
- b) ndarja sipas kodeve bazuar ne VKM nr.402 date 30.06.2021 Per miratimin e Katalogut te mbetjeve
- c) rikuperimi i mbetjeve te ndertimit nga frontoja
- d) pergatitja e mbetjeve per tu transportuar drejt subjekteve te licensuara per trajtimin e metejshme te tyre (i cili perfshin paketimin dhe peshen nese eshte e nevojshme).

Pjesa me e madhe e mbetje ne stacionin e transferimit do te jene mbetje te ngurta te ndryshme te pa rrezikshme nga aktiviteti i ndertimit, por vecanerisht nga aktiviteti i prishjes se objekteve egzistuese apo punimet e rikonstruksonit te objekteve te ndryshme. Prishja ose ndertimi i objekteve te ndryshme veprave inxhinierike te tilla si ura, rruge, apo cdo objekt tjeter ne varesi te projektit per te cilin subjekti ka fituar tenderin perkates nga institucionet shteterore apo ne siperrmarrjet private.

Proceset e punes ne lidhje me kete aktivitet jane:

- Grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve te ngurta qe gjenerohen nga aktiviteti ndertimor, prishjes apo rikonstrukcioni ne stacionin e transferimit
- Mbetjet do te transportohen nga burimi i marrjes per ne stacionin e transferimit te mbetjeve ku do te shkarkohen nga kamionet te cilet jane vete-shkarkues

- Pasi mbetjet e ngurta te shkarkohen ne ambjentet qe disponon shoqerisa "PEPA GROUP"sh.p.k, do te sistemohen me ane te makinerive qe jane ne pronesi.
- Fadromat do te mundesojne sistemimin e mbetjeve me qellim ngritjen e pargut deri ne lartesine 2.5 – 3 m te larte dhe shfrytezimin sa me eficient te siperfaqes.
- Transportimin e tyre ne vendgrumbullimet perkatese te percaktuara sipas kontratave perkatese.

Ne rastet e ndertimit te rrugeve, prodhohen blloqe betoni, tulla, gure, etj, profile metalike ferore dhe joferore nga sinjalistika, bordurat mbrojtese, etj apo asfalti i cili germohet nga rruga. Keto mbetje, do transportohen ne stacionin e transferimit te mbetjeve te kompanise, nga ku mund ti nenshtrohen nje procesi pastrimi, sistemi apo ndarje dhe me pas te riperdoren , apo te shiten si skrap.

Betonin dhe inerte, mund ti riperdorim ne proceset e prodhimit te betonimit te nje cilesie te dores se dyte qe perdoret per mbushje.

Mbetjet inerte qe do te rikuperohen do te jene mbetjet qe dalin vetem nga aktiviteti ndertues i shoqerise. Qellimi i copetimit dhe bluarjes eshte reduktimi i sasise se ketyre mbetjeve si dhe te mund te riperdoren ne proceset ndertimore si lende paresore dhe dytesore.

Mbetjet inerte qe jane objekt riperdorimi ne kete aktivitet jane mbetjet qe prodhohen gjate punimeve te prishjes apo ndertimit te objekteve dhe rrugeve.

**Mbetjet inerte me kod 17 do te sistemohen ne shesh te vecante ne afersi te frontos per rikuperimin e tyre.**

Kodi	Lloji i mbetjes	Mënyra e grumbullimit
17 01 01	Beton	Në zone të ndar në kantier pa përzierje me tokë ose mbetje të tjera.
17 01 02	Tulla	Grumbullohen veç, mund të riciklohen si inerte.
17 01 03	Tjegulla dhe qeramika	Mblidhen në thasë të fortë ose kontejnerë të veçantë.
17 01 07	Përzierje betoni, tullash, tjegullash dhe qeramike	Përdoren për mbushje ose dërgohen për përzgjedhje dhe riciklim në impiant.
17 02 01	Dru	Copëza, dërrasa, trarë; mblidhen veç për ripërdorim ose riciklim.
17 02 02	Qelqe	Grumbullohen me kujdes për të shmangur thyerjen, në enë të mbyllura.
17 02 03	Plastikë	Mblidhet në kontejnerë të shënuar, riciklohet.
17 03 02	Përzierje bituminoze (jo të ndotura)	Grumbullohen në zona të veçanta, pa përzierje me mbetje të tjera.
17 04 05	Hekur dhe çelik	Ndahet për riciklim si skrap metalik; mblidhet në zona të sigurta.
17 04 07	Metale të përziara	Grumbullohen dhe klasifikohen sipas llojit të metalit kur është e mundur.
17 05 04	Dhera dhe gurë	Mblidhen për mbushje ose rikultivim terreni.
17 05 06	Balta	Mblidhet dhe përdoret për rikuperim ose mbulim.
17 05 08	Çakëll	Mblidhet veçmas; mund të ripërdoret për baza rruge apo mbushje.

Kodi	Lloji i mbetjes	Mënyra e grumbullimit
17 09 04	Mbetje të përziera ndërtimi/prishje	Vetëm ato që nuk mund të ndahen; grumbullohen në kontejnerë të veçantë.

### Ruajtja në kantier ose stacion transferimi

Mbetjet ruhen përkohësisht në një hapësirë të përcaktuar dhe të kontrolluar, deri në transportim.

Kushtet e ruajtjes:

- Sipërfaqe e shtruar dhe e papërshkueshme nga uji për të shmangur ndotjen e tokës.
- Ndarje fizike e fraksioneve (beton, tulla, metale, dru, plastikë etj.).
- Etiketim i kontejnerëve me kodin dhe llojin e mbetjes.
- Materialet e riciklueshme (metale, plastikë, dru, qelq) ruhen në zona të thata.
- Inertet (beton, tulla, çakëll, gurë) ruhen në hapësira të rrethuar për të shmangur shpërndarjen e pluhurit.
- Përzierjet bituminoze ruhen në zona të mbuluara, larg ujërave të shiut.
- Mbetjet e përziera do të ruhen për një periudhë të shkurtër, deri në ndarjen ose dërgimin për trajtim.

### Largimi / Dorëzimi për riciklim ose depozitimi

- Largimi i mbetjeve bëhet vetëm përmes operatorëve të licencuar për transport dhe trajtim të mbetjeve ndërtimore.
- Çdo dërgesë shoqërohet me formular transferimi mbetjesh (FTM) me:
  - Kodin të mbetjes,
  - Sasinë (në ton),
  - Destinacionin (shoqëria për riciklim ose landfilli).
- Materialet e riciklueshme/rikuperueshme:
  - Betoni, tulla, tjegulla, qeramika → frontoja e instaluar për rikuperimin e ketyr embetjeve
  - Metalet (17 04 05, 17 04 07) → dërgohen në shoqëri ricikluese skrap sipas kontrates
  - Dru, plastikë, qelq → operatorë riciklimi specifikë sipas materialit sipas kontrates
- Dhera, gurë, balta, çakëll → ripërdoren për mbushje ose stabilizim terreni.
- Mbetjet e përziera (17 09 04) → dërgohen në landfill të miratuar sipas kontrates.

Persa l perket mbetjeve metalike /skrap Këto mbetje zakonisht përfshijnë Metale hekur-mbajtëse (ferro): hekur ndërtimor, profile çeliku, llamarina, armaturë betoni, tuba, etj.

Në stacionin e transferimit, që do shërbej si pikë grumbullimi e përkohshme, dotë respektohen standardet për ruajtje të sigurt e të kontrolluar:

1. Ndarja sipas llojit të materialit
  - Skrapi metalik ndahet në zona të veçanta (ferro dhe jo-ferro).
  - Pjesët voluminoze priten ose shtypen për të zënë më pak hapësirë.
2. Sipërfaqja e depozitimit

- Do të jetë e shtruar dhe e papërshkueshme nga uji, për të shmangur ndotjen e tokës.
  - E rrethuar dhe e mbuluar pjesërisht për mbrojtje nga shiu.
3. Pajisje për grumbullim
    - Kontejnerë metalikë ose kontenierë të mbyllur.
    - Përdorim i vinçave magnetikë apo presa kompaktuese për trajtim më efikas.
  4. Masat e sigurisë dhe mbrojtjes mjedisore
    - Kontroll për lëndë të rrezikshme (vajra, bojëra, bateri).
    - Ndalohet përzierja e mbetjeve metalike me mbetje të tjera ndërtimore (si beton apo drurë).

#### Dërgimi për riciklim

- Pasi të jenë peshuar, regjistruar dhe klasifikuar, mbetjet skrap ngarkohen në automjete të licencuara për transport mbetjesh.
- Çdo ngarkesë shoqërohet me formular të transferimit të mbetjeve, që dokumenton llojin, sasinë dhe destinacionin.
- Dërgohen në shoqëritë ricikluese të licencuara sipas kontrates që ka lidhur shoqëria PEPA GROUP shpk, ku materialet përpunohen (shkrirje, pastrim, ndarje sipas përbërjes metalike).

#### Qëllimi dhe përfitimet

- Riciklimi i skrapit redukton nevojën për nxjerrje të metaleve të reja.
- Ul ndotjen nga depozitimi i mbetjeve ndërtimore.
- Rrit eficiencën ekonomike të kompanive ndërtimore përmes shitjes së skrapit të riciklueshëm.

Nga aktiviteti i mirëmbajtjes së automjeteve në oficinën e shoqërisë dalin gomat e përdorura (të konsumuara), të cilat klasifikohen si mbetje jo të rrezikshme me kod 16 01 03 – Goma jashtë përdorimit.

Këto mbetje dalin:

- gjatë ndërrimit të gomave të dëmtuara ose të konsumuara të automjeteve të shoqërisë;
- nga zëvendësimi sezonal i gomave verë/dimër;
- në raste të dëmtimeve mekanike gjatë përdorimit.

Pasi hiqen nga automjetet, gomat do ruhen përkohësisht në hapësirën e dedikuar pranë oficinës deri në dërgimin për riciklim ose trajtim në shoqëri të licensuara.

Kushtet e ruajtjes:

1. Zona e grumbullimit
  - Brenda territorit të shoqërisë, në një hapësirë të shtruar dhe të rrethuar.
  - Larg burimeve të nxehtësisë apo flakës së hapur, për të shmangur rrezikun e zjarrit.
  - Mundësisht e mbuluar ose e mbrojtur nga reshjet për të shmangur grumbullimin e ujit brenda gomave (parandalim i mushkonjave dhe ndotjes së ujërave).
2. Mënyra e ruajtjes
  - Gomat do vendosen të grumbulluara vertikalisht/ horizontalisht në stiva të sigurta.
  - Ndahet goma e plotë nga ajo e dëmtuar ose e papërshtatshme për ripërdorim.
  - Nuk lejohen mbetje të tjera (vajra, bateri, filtra etj.) në të njëjtën zonë.

3. Sasia dhe kohëzgjatja e ruajtjes
  - Grumbullimi bëhet deri në sasinë e arsyeshme që justifikon transportin ekonomik.
  - Ruajtja është përkohshme, jo më shumë se disa muaj, derisa të dërgohen tek operatori i licencuar.
  - Transporti kryhet nga transportues të licencuar për mbetje.
  - Çdo dërgesë shoqërohet me formular transferimi mbetjesh, ku shënohet: emri i mbartësit, lloji i mbetjes, sasia (në copë ose kg), destinacioni përfundimtar.

### **Persa i perket mbetjeve urbane me kodin 20**

- Mbetjet grumbullohen në burim, pra aty ku krijohen (zyra, kuzhina e punonjësve, kantier, ambientet e punës).
- Sigurohet ndarja në fraksione për të lehtësuar riciklimin dhe trajtimin:
  - **20 01 01 Letër dhe karton**– krijon nga puna e përditshme në zyrë, vendosen në kuti kartoni
  - **20 01 02 Qelq**– krijohen nga aktiviteti përditshëm I punonjësve, grumbullohen në kontejnerë të veçantë, pa kapak hermetik (për të shmangur thyerjet e tepërta).
  - **20 01 08 Mbetje të biodegradueshme nga kuzhinat dhe mensat** - krijohen nga aktiviteti përditshëm I punonjësve, ruhen në kontejnerë të mbyllur hermetikisht dhe pastrohen rregullisht.
  - **20 01 10 Veshjet** – këtu futen veshjet e punës së punëtorëve të cilat dalin jashtë përdorimit, ruhen në qese ose kontejnerë të mbyllur për materiale të pastra.
  - **20 01 11 Tekstilet** – copa, lecka që përdoren për pastrim të zyrave, ruhen në qese ose kontejnerë të mbyllur për materiale të pastra.
  - **20 01 38 Mbetje druri të tjera nga ato të përmendura në 20 01 37** - copa, paleta, mobilie të vogla, ruhen në zona të veçanta magazinimi.
  - **20 01 39 Plastikë**– aktiviteti përditshëm I punonjësve, ambalazhe të ndryshme për produkte ushqimore dhe jo vetëm, ruhen në kontejnerë plastike
  - **20 01 40 Metale**– kanaçe, llamarina, pjesë metalike të vogla, ruhen në kontejnerë metalikë.
  - **20 01 99 Fraksione të tjera të paspecifikuara** – mbetje të cilat nuk klasifikohen në asnjë nga kodet e katalogut
  - **20 02 01 Mbetje të biodegradueshme** – mbetje nga pastrimi i hapësirës të gjelbrës, kopshtit për zyrë si gjethë të luleve dekorative, dege, kercej, ruhen në kontejnerë të mbyllur hermetikisht, të pastrohen rregullisht.
  - **20 02 02 Dhera dhe gurë** – mbetje nga rehabilitimi apo rikonstruksioni i rrugëve të ndryshme nga shoqëria, ruhen në shesh të vecantë
  - **20 02 03 Mbetje të tjera të pabidegradueshme** – ruhen në shesh të vecantë
  - **20 03 Mbetje të tjera urbane**
  - **20 03 01 Mbetjet e përziera urbane** - ruhen në kontejnerë të zakonshëm për mbeturina të mbetura.
  - **20 03 03 Mbetje nga pastrimi i rrugëve**- mbetje që krijohen nga pastrimi i rrugëve përpara se të nenshtrohen rehabilitimit apo rikonstruksionit nga shoqëria, ruhen në thasë ose kontejnerë të mbyllur për transport.

- **20 03 07 Mbetjet të vëllimshme** – mobilie ( tavolina apo rafte te demtuara qe nuk perdoren me nga zyrat ) , pajisje të mëdha, ruhen veçmas deri në largim.
- **20 03 99 Mbetjet urbane të paspecifikuar**- mbetje te cilat nuk klasifikohen ne asnje nga kodet e katalogut

Ruajtja në ambientet e shoqërisë / stacionin e përkohshëm të mbetjeve

- Mbetjet ruhen në një hapësirë të dedikuar, të shtruar dhe të rrethuar, me qasje të kufizuar vetëm për personelin e autorizuar.
- Zona e ruajtjes duhet të:
  - ketë kontejnerë të etiketuar sipas llojit të mbetjes,
  - jetë e mbuluar ose e mbrojtur nga reshjet,
  - sigurojë ndarje të qartë midis mbetjeve riciklueshme dhe atyre të përziera.
- Mbetjet organike (biodegradueshme) duhet të largohen më shpesh për të shmangur erërat apo ndotjen.
- Materialet e riciklueshme (letër, plastikë, qelq, metal) mund të ruhen më gjatë, por gjithmonë në gjendje të pastër dhe të thatë.
- Mbetjet vëllimore (mobilie, drurë) ruhen në zona të veçanta të oborrit, në mënyrë që të mos pengojnë qarkullimin apo të përbëjnë rrezik zjarri.

Largimi / Dorëzimi për trajtim ose riciklim

- Largimi i mbetjeve kryhet nga operatorë të licencuar për mbledhje dhe transport mbetjesh.
- Çdo dërgesë shoqërohet me formularin e transferimit të mbetjeve (FTM) që përmban:
  - emrin e prodhuesit (shoqërisë),
  - llojin dhe kodin e mbetjes
  - sasinë (kg ose ton),
  - destinacionin (operatori përfundimtar).
- Fraksionet ricikluese (letër, plastikë, metal, qelq, drurë) dërgohen në shoqëri ricikluese të licencuara.
- Mbetjet organike (biodegradueshme), Mbetjet e përziera urbane transportohen në landfill të miratuar.
- Mbetjet e vëllimshme merren periodikisht nga shoqëri te licensure.

### **Pershkrimi i veprave inxhinerike qe jane ndertuar ne sherbim te impianteve**

#### **Rrethimi objektit**

Rrethimi perfshin gjithe siperfaqen ku eshte instaluar impianti i prodhimit te betonit, frontoja per fraksionimin e inerteve dhe rikuperimin e mbetjeve inerte , siperfaqja qe do et sherbej per grumbullimin dhe ruajtjen e perkohshme te mbetjeve dhe ka per qellim te ndaloje komunikimin e njerezve qe nuk kane lidhje pune dhe hyrjen e kafsheve ne territorin e tij.

#### **Ndricimi objektit**

Ndricimi objektit behet nga rrjeti elektrik.

Ndricimi eshte projektuar modern sa me afer ndricimit diellor dhe te jete dekorativ.

Ndricimi i territorit te objektit, rrugelimit te makinave, te njerezve, rrethimit, etj, behet me projektore te vendosura ne shtylla metalike me lartesi 8-10m.

Ndersa ndricimi vendeve te punes se punonjesve ne sheshin e linjes, bunkerin e shkarkimit te makinave, panelin e komandimit behet me ndricues neoni. Paisjet e ndricimit si llampat, celsat, leshuesit etj jane te tipit normal.

Ndersa kabllot elektrik te futura ne tuba celiku. Keto masa merren me qellim qe po te ndodhin lidhje te shkurtra ne percjellesat, ndricuesit, celsat, leshuesit, elektromotoret etj te mos kete kontakt me ambientin e jashtem.

### **Tokezimi**

Te gjitha paisjet jane te tokezuara. Rezistenca e tokezimit nuk eshte me e madhe se 5 om. Tokezimi mbron njerezit nga renia ne tension, paisjet nga rrymat rrjedhese, ngarkesat statike dhe shkarkimet elektrike.

#### **a) Pershkrim I shkurter I mbuleses bimore te siperfaqes ku propozohet te zbatohet projekti**

Per nga origjina , perberja dhe vecorite gjeobotanike bimesia e Shqiperise ben pjese ne nenzonen floristike mesdhetare e cila perfshihet ne nje njesi me te madhe, ne zonen holarktike. Ndikim te madh ne zhvillimin e flores mesdhetare ushtroi ftohja e pergjithshme e klimes ne periudhen e pleistocenit dhe akullzimi i fuqishem qe pasoi ate. Tiparet karakteristike te bimesise mesdhetare si per sa i perket vecorive gjeobotanike ashtu edhe perberjes morfologjike dhe shtrirjes vertikale te saj, jane karakteristike edhe per bimesine e vendit tone. Por kushtet konkrete te zhvillimit, sidomos te klimes dhe te relievit kane percaktuar edhe vecorite origjinale te flores se Shqiperise.

E gjithë kjo pasuri floristike i detyrohet vecorive te evolucionit paleogeografik te Shqiperise dhe sidomos larmise se madhe te klimes, copetimit te theksuar te relievit dhe formave te shumellojshme te tij, formacioneve te shumta shkembore ( gelqerore, magmatike, terrigjene) etj.

Fitocenozat e bimesise barishtore shume te larmishme nga perberja e llojeve, gjenden ne te gjitha zonat fitoklimatike te Shqiperise. Megjithese fitocenozat barishtore nga ana e fizionomise ne pergjithesi duken relativisht te peraferta, ato ndryshojne midis tyre nga perberja floristike ne varesi te faktoreve ekologjike. Me perjashtime te pakta, gati ne te gjitha fitocenozat dhe bashkeshoqerimet barishtore gjenden perfaqesues te familjes graminore ( Graminaceae).

Ne Evrope vendi jone radhitet ne vendet me llojshmeri bimore me te madhe, qe lidhet me ndryshimin e klimes, te tokave, te relievit etj. Ne rajonet perendimore dhe bregdetare mbizotrojne llojet mesdhetare te bimesise si: mareja, shqopa, ilqja, etj., kurse ne brendesi te tyre, bimet e Evropes Lindore dhe Qendrore si: dushku, ahu, bredhi, pisha e zeze etj. Gjithashtu jane te shumta bimet endemike, pra bimet qe riten vetem ne vendin tone. Per shkak te mbizotimit te relievit kryesisht kodrinoro-malor, qe kushtezon ndryshime te dukshme te klimes dhe te faktoreve te tjere, bimesia eshte e shkallezuar ne drejtimin vertikal ne kater breza: brezi i shkurreve dhe i pyjeve mesdhetare, brezi i dushqeve, brezi i ahishteve dhe i haloreve dhe brezi i kullotave alpine.

Impianti i prodhimit te betonit eshte ekzistues i cili operon prej disa vitesh , eshte instaluar mbi nje siperfaqe te betonuar dhe ne afersi te tij eshte vendosur frontoja. E gjithë siperfaqja ku zhvillon aktivitetin shoqeria eshte ne pronesi te saj , ne perimetrin rrethues jane mbjell peme dekorativ ndersa bimesia qe rritet ne zone eshte kryesisht shkurre ndersa banore te fshatit Kashar kultivojne edhe peme frutore.

#### **b) Informacion per pranine e burimeve ujore ne siperfaqen e kerkuar nga projekti dhe ne afersi te saj**

NJA Kashar është një prej njesive vendore më të mëdha të Qarkut të Tiranës në Shqipëri. Ndodhet në perëndim të qytetit të Tiranës dhe ka një popullsi prej rreth 25,000 banorësh. Relievi është

kryesisht fushor dhe kodrinor, por dominohet nga hapësirat fushore. Klima është kryesisht mesdhetare, me dimër të butë e të lagësht dhe verë të ngrohtë. Pozita gjeografike e favorshme e kësaj zone e bën atë një destinacion të përshtatshëm turistik, duke përfshirë burimet kryesore të të ardhurave. Rezervuarët dhe peizazhi kodrinor krijojnë një panoramë tërheqëse, duke rritur interesin e turistëve vendas dhe të huaj për aktivitete si hipizmi, ciklizmi, dhe të tjera. Zona e Kasharit ka një traditë të zhvilluar të vreshtarisë dhe bujqësisë. Kjo traditë vazhdon të qëndrojë aktive edhe sot, megjithëse në mënyrë të privatizuar.

Tirana përfshihet në pellgun ujembledhës të lumenjve Erzen dhe Ishem, i cili formon një basen të vetëm ujor nga gjashtë në total që ka vendi. Ishmi formohet nga bashkimi i ujerave të lumit të Tiranës, lumit të Terkuzes dhe lumit të Zezes, ndër të cilët si dege kryesore konsiderohet lumi i Tiranës. Pellgu i tij ujembledhës pozicionohet në Shqipërinë e Mesme ndërmjet pellgut të Matit në veri dhe pellgut të lumit Erzen në jug, vija ujendarese me të cilin kalon nëpër mallet Micaku i Shen Merisë (1828 m) dhe atë të Dajtit (1612 m). Ai ka një sipërfaqe prej 673 km<sup>2</sup> me lartësi mesatare 357 m mbi nivelin e detit, ndërsa gjatësia e shtratit është 79.2 km. Në përgjithësi, të tre degët kryesore të tij dhe që rrjedhin në territorin e bashkisë Tirane, ruajnë karakteristikat e perrenjve malorë me rrjedhje të rrembyeshme gjatë pilotave dhe me koheardhje të vogël. Lumi i Tiranës ka një gjatësi rreth 35 km dhe në pjesën e sipërme të tij formohet nga tre degë: Perroi i Mojsitit, Selites dhe Zall-Bastarit. Në largësi 2.5 km nga qendra e komunes Zall-Dajt ai ndërron emrin dhe quhet lumi i Tiranës dhe vazhdon me këtë emërtim deri në afërsi të fshatit Larushk, ku bashkohet me lumin e Lanes, i cili përshkon Tiranën nga verilindja në jugperëndim, ka një gjatësi prej 29 km, sipërfaqe ujembledhëse 67 m<sup>2</sup>, lartësi mesatare 179 m mbi nivelin e detit dhe rnie 24 m/km; dhe ai i Limuthit, i cili ka sipërfaqe të pellgut ujembledhës 31 km<sup>2</sup>. Lumi i Tiranës furnizohet me ujë të Selites dhe të disa perrenjve me të vegjël me karakter stinor, që derdhen në shtratin e tij. Lumi i Terkuzes rrjedh në veriperëndim të Tiranës dhe në afërsi të Fushe Prezes bashkohet me lumin e Tiranës. Ai buron në pjesën veriperëndimore të Malit me Gropa dhe ka një gjatësi rreth 44.1 km. Pellgu i tij ujembledhës ka një sipërfaqe 182 km<sup>2</sup>, lartësi mesatare 458 m mbi nivelin e detit dhe rnie 22 m/km. Përpara ndërtimit të rezervuarit të Bovilles, shtimi i rrjedhës së lumit gjatë stinës së dimrit dhe pranverës shkaktonte përmbajtje të shumta. Me ngritjen e rezervuarit të Bovilles dhe disiplinimin e shtratit me prita të argjinaturës, ujerat e lumit të Terkuzes janë shfrytëzuar dhe shfrytëzohen për furnizimin me ujë të qytetit të Tiranës. Lumi i Zezes ka një gjatësi të përgjithshme prej 29 km. Sipërfaqja e pellgut ujembledhës të këtij lumi është 71.3 km<sup>2</sup>, ndërsa lartësia mesatare 487 m mbi nivelin e detit. Lumi i Zezes dallohet për regjim torrencial (të rrembyer) dhe e siguron 68% të ujit nga reshjet që bien në pellgun ujembledhës të tij. Prurja mesatare shumëvjeçare e tij është  $Q_0 = 2.15 \text{ m}^3/\text{s}$ , ndërsa koeficienti i rrjedhës është 0.68 dhe për këtë arsye, në rast të prurjeve të mëdha, lumi i Zezes shkaktonte përmbajtje në zonat e ndodhura pranë brigjeve të tij. Ndërtimi litologjik i pellgut ujembledhës të Ishmit favorizon krijimin e një rrjedhe të fuqishme nëntokesore, e cila përfaqëson 40% të rrjedhës së tij vjetore. Ujerat e lumit Ishem përdoren kryesisht për ujë.

**Ujërat nëntokesorë** Në pikepamje hidrogeologjike, territori i Bashkisë Tirane shtrihet mbi akuiferin e zhavorreve të Kuaternarit të Tiranës, i cili përfaqëson zonën e ushqimit të pellgut të madh ujembajtës të Tirane – Ishmit. Në këtë pellg, horizonti kryesor ujembajtës përfaqësohet nga depozitimet e zhavorreve me përhapje në të gjithë zonën ku shtrihet qyteti i Tiranës, Kombinati, Yzberishi, Mezezi, Laknasi, Valiasi etj. Trashësia e depozitimeve rritet nga qyteti në drejtim të Selites së Vogel, Kombinat, Mezezi-Laknas. Trashësia e shtresës ujembajtëse varion nga 2-3 m, në 5-10 m, trashësi me të mëdha ka në sektoret Selite e Vogel, Unaza e Re, Kombinat, Mezezi-Laknas. Shtresa

ujembajtese ka tregues te mire hidraulik, prurja specifike varion nga 2-5 l/sek/m deri ne 10-20 l/sek/m, koeficienti i filtrimit varion nga 50-100 m/dite ne 200-400 m/dite. Koeficienti vjetor i shfrytezimit te akuiferiteve te kuaternarit varion  $K= 0.85 - 0.95$ , ndersa sasia e ujit qe shfrytezoheq eshte  $Q= 1200 - 1300$  l/sek dhe perdoret per furnizimin me uje te pijshem te qytetit te Tiranes, Kamzes dhe qendra te tjera te banuara dhe si uje teknologjik. Per sa l perket karakterit te ujeave nentokesore te ketij pellgu, takohen kryesisht ujera pa presion (qyteti l Tiranes, Laprake etj.) dhe me presion, por pa veterrjedhje (Kombinat, Selite, Laknas etj.) dhe me presion, por pa veterrjedhje (Kombinat, Selite, Laknas). Ujerat nentokesore te pellgut Tirane ushqehen nga infiltrimet e reshjeve atmosferike, ne vecanti kur ato jane pa presion, si dhe nga infiltrimet e ujerave siperfaqesore te lumenjve Tirane, Terkuze. Vetite fiziko-kimike te ujerave jane te mira me  $Mp = 0.5 - 0.8$  mg/l. Nga analizat e kryera rezulton se jane neutral, jo agresive ndaj hekurit dhe betonit.

**Ne siperfaqen ku zhvillohet aktiviteti dhe ne afersi te zones ku ushtrohet aktiviteti nuk ka burime ujore siperfaqesore.**

- c) Nje identifikim te ndikimeve te mundshme negative ne mjedis te projektit, perfshire ndikimet ne biodiversitet, toke, uje, ajer.**

#### *Ndikimet ne biodiversitet*

Problemet e biodiversitetit perbejne aktualisht nder problemet me me rendesi ne rruzullin tokesor. Termi biodiversitet eshte shume kompleks dhe si i tille, zhvillimi dhe percaktimi i strategjive te pershtatshme per mbrojtjen e tij, shoqerohet me nje proces te veshtire zgjedhjesh dhe vendimmarrjesh. Biodiversiteti perben teresine e llojeve dhe ekosistemeve ne nje rajon, apo ne gjithë rruzullin tokesor. Ekosistemet jane te nje rendesie te vecante sepse ato perbejne bazat per ekzistencen e llojeve. Cenimi i tyre, si rezultat i aktiviteve te ndryshme ekonomike shoqerore perben nje shqetesim per njerezit dhe studiuesit . Vlera e nje biodiversiteti te larte per njerezimin jepet para se gjithash nepermjet funksionit te tij si stabilizator i biosferes dhe si burim direkt i prodhimit.

Nga ky aktivitet nuk demtohet flora dhe fauna e rrezikuar e percaktuar ne VKM nr. 804. dt. 4.12.2003 dhe e listuar ne urdherin e Ministrit nr. 146,dt.8.5.2007 Nga subjekti ne zbatim te projektit do te merren masa qe zona ne shfrytezim te jete gjithmone e kufizuar dhe te rehabilitohet duke u pyllezuar.

Zona ku ushtrohet aktiviteti nuk perfaqeson zone me rendesi te vecante dhe per kete arsye nuk eshte parashikuar sipas Strategjise per "Ruajtjen e Biodiversitetit dhe Planit te Veprimit si Zone e Mundeshme" per tu shpallur "Peizazh i mbrojtur".

Nuk pritet ndryshim i ekosistemit pasi shoqeria eshte dhe do te tregohet mjaft e kujdesshme ne zbatimin e teknologjive dhe metodeve per prodhimin e betonit, fraksionimin e inerteve, grumbullimin dhe ruajtjen e mbetjeve si dhe rikuperimin e mbetjeve inerte dhe do te jete e gatshme te zbatoje te gjitha masat qe do ti rekomandohen per uljen e ndikimit.

Ndersa per te menjanuar erozionin nga ujerat e rreshjeve atmosferike ne perimentrin perreth objektit ndertohen kanale dhe kuneta qe ujerat te drejtohen ne zona qe nuk demtojne token si dhe habitatet e flores dhe faunes se zones.

### *Ndikimet ne toke*

Gjate procesit te fraksionimit te gjitha inertet te cilat nuk fraksionohen rifuten ne proces fraksionimi. Ky aktivitet nuk gjeneron mbetje te ngurta ne forme sterilesh te demshem per mjedisin, ne impiantin e thyerje fraksionimit nuk ka mbetje te ngurta. Mbetje te tjera te cilat dalin nga aktiviteti i perditshem i punetoreve grumbullohen ne kontenier dhe me pas largohen per ne vendin e caktuar nga pushteti lokal i zones konform kerkesave te percaktuara.

Nga vleresimet e kryera, shkarkimet ne mjedis jane te uleta persa l perket mbetjeve te ngurta dhe materialeve te tjera te ngurta dhe si rrjedhoje nuk perbejne problem serioz per mjedisin. Megjithese perparosite dhe domosdoshmerine qe ka ky aktivitet duhet te tregohet kujdes ne menaxhimin dhe mbajtjen nen kontroll te kushteve teknike per te minimizuar humbjet e materialit dhe ndotjen e mjedisit.

Persa i perket mbetjeve inerte qe do te grumbullohen per tu rikuperuar theksojme se nuk kane ne perberje te tyre komponente te rrezikshem.

### *Ndikimet ne uje*

Keto procese teknologjike nuk shoqerohen me shkarkime te lengeta te rrezikshme.

Ujerrat qe dalin nga larja e autobetoniereve ndikon ne rritjen e pH te ujerave prites si dhe rrisin turbulliren per shkak se permbajn cemento , rere dhe aggregate. Impianti eshte instaluar ne shesh te betonuar , ujerat qe dalin nga larja kalojne ne vaske dekantuese. Nje pjese e ujit te vaskes dekantimit perdoret per sperkatjen e territorit per eliminimin e pluhurave, pjesa tjeter i bashkohet kanalizimit te zones. Ne menyre periodike sipas kushteve te lejes se mejdisit ekzistuese kryhet monitorimi i cilesise se ujit qe del nga vaska dekantimit, parametrat e te cilit kan rezultuar Brenda normave te lejuara.

Uji qe do perdoret per sperkatje do te jete ne forme pulverizimi. Ujerat e shirave sistemohen me kanale dhe pas i bashkohen rrjetit te zones.

Projekti nuk ndikon negativisht ne modelin drenazhues te zones. Ai do te zbatohet vetem ne nje siperfaqe te kufizuar dhe brenda kufijve te miratuar. Zbatimi i projektit nuk çon në ndryshime hidrografike te nivelit të ujrave, të rrugëve ujore, të rrjedhjes të ujrave nëntoksorë dhe sipërfaqësorë etj. Ky projekt nuk ka ndikim në hidrologjinë bregdetare per shkak se ndodhet larg vijes bregdetare.

### *Ndikimet ne ajer*

Referuar natyres se procesit nuk ka sasi gazesh te emetuara ne atmosfere por vetem perhapje te pluhurit. E cila eshte prezente ne shesh gjate kohes se thate nga levizja e mjeteve ne kohen e ngarkimit te inerteve te fraksionuara ne bunkeret e depozitimit te impiantit te betonit dhe gurit gelqeror ne fronton e fraksionimit dhe te ndonje rast tek peshimi e furnizimi. Si dhe gjate shkarkimit te mbetjeve te ndertimit ne sheshin ne afersi te frontos per tu future per rikuperim.

Furnizimi i sillosave te cimentos kryhet me transportier te mbyllur dhe gjate ketij procesi nuk kemi emetim te grimcave te pluhurit ne ajer. Rezervat e lendeve te para porositen ne sasi per te permbushur kerkesat e pritshme per prodhimin e betonit dhe per kete arsye nuk ka stoqe te medha te materialit te ruajtuar ne bunkera. Lendet e para ruhen te ndara nga njera tjetra dhe me orientim nga veriu larg nga ererat mbizoteruese. Ne kohe te thate dhe me ere rezervat e lendes se pare lagen per te shmangur emetim te pluhurave.

Gjithashtu per shmangien e pluhurit behet sperkatje me uje her pas here ne sheshin e punes sidomos ne kohe te thate dhe me ere. Gazet prej mjeteve jane ne interval kohore te shkurtera e pa

ndonje ndikim ne mjedisin perreth. Per te pakesuar gazet toksike makinat e transportit dhe ngarkimit do te jene te pajisur me marmite me katalizatore te kapjes se gazeve toksike.

Ndikimet e identifikuara nga zhvillimi i aktivitetit jane ndikime direkte ne mjedis.

*Tabela e identifikimit te ndikimeve te mundeshme negative ne toke.*

	<b>Ndikimi i mundshem</b>	<b>Sqarim</b>
1	Derdhja pa dashje e vajrave dhe lubrifikanteve nga mjetet e punes.	Behet fjale per ndonje rast te rralle te rrjedhjes gjate difekteve dhe çarje te tubave dhe sotokartit te mjeteve motorike dhe nderrimit te vajrave ne makinerite e impiantit te betonit dhe frontos fraksionimit.

*Tabela e identifikimit te ndikimeve te mundeshme negative ne ajer.*

	<b>Ndikimi i mundeshem</b>	<b>Sqarim</b>
1	Shkarkimi i gazeve ne sasi minimale nga lenda djegese	Sasia e gazeve nga djegia e karburantit qe do te shkarkohet nga mjetet motorrike. Eshte standart i teknologjise se prodhimit te mjeteve dhe i karburantit.
2	Emetimi i zhurmave nga puna e makinerive te impianteve.	Vlerat standart te emetimit te zhurmave sipas teknologjise se prodhimit te makinerive, kontroll teknik te makinerive te shoqerise.

*Tabela e identifikimit te ndikimeve te mundeshme negative ne biodiversitet.*

	<b>Ndikimi i mundeshem</b>	<b>Sqarim</b>
1	Shqetesim i mundeshem i faunes.	Ndikim i perkoshem.

**d) Nje perskrim te shkurter per shkarkimet e mundshme ne mjedis te tilla si , ujera te ndotura, gaze dhe pluhur, zhurme, si dhe prodhimin e mbetjeve**

Uji do perdoret per lagjen e territorit per paksimin e pluhurave dhe do sigurohet permes pusit i cili eshte i pajisur me leje. Ujerat e shiut do te sistemohen permes kanaleve perimetrike dhe me pas do i bashkohen ujrave te çarjeve, debiti i te cilave varet nga reshjet atmosferike. Theksojme se ujerat nuk permbajne elemente kimike ndotes.

Zhvillimi i aktivitetit do te sjell emetime te pluhurave ne mjedis gjate levizjes se mjeteve, burime te tjera ndotese per ajrin nuk do te kete. Gazet prej mjeteve jane ne interval kohore te shkurtra e pa ndonje ndikim ne mjedisin perreth. Per te pakesuar gazet toksike makinat e transportit dhe ngarkimit do te jene te pajisur me marmite me katalizatore te kapjes se gazeve toksike.

Ky aktivitet kryhet ne nje zone e cila njihet si zone industriale ku zhvillojne aktivitet biznese te ndryshme.

*Ndikimi nga zhurmat ne fazen funksionale te aktivitetit*

Burimet e zhurmave jane ne siperfaqe. Cdo burim perhap vate zhurme. Fusha akustike qe rezulton varet nga karakteristikat e absorbimit dhe reflektimeve te te gjitha pengesave ekzistuese, ndermjet burimit dhe receptorit.

Shoqeria eshte kujdesur te importoje nga jashte pajisje bashkekohore dhe ne gjendje te mire teknike, ne menyre te tille qe zhurmat e krijuara prej tyre te mos sjellin ndotje akustike dhe te jene te demshme per mjedisin dhe shendetin e punonjesve.

Ndikimet e zhurmave gjate fazes funksionale do te vijne nga mjetet qe do te sjellin lendet e pare ne impiantine betonit dhe mineralin gelqeror per fraksionim ne fronto dhe mjetet per transportin e betonit te prodhuar. Niveli i zhurmave te gjeneruara eshte i atij niveli qe nuk influencon si per te punesuarit dhe per banoret dhe gjallesat perreth tij. Koha ne te cilen do te jene te pranishme keto zhurma eshte vetem gjate dites, meqenese ne objekt do punohet vetem me nje turn. Niveli i zhurmave te ketyre mjeteve ne largesi nuk do te jete i madh dhe do te jete konform normave ne fuqi.

Energjia zvoglohet per gjate rruges si rezultat i absorbimit te siperfaqeve, divergjences gjeometrike dhe absorbimit atmosferik.

Program i perdorur per llogaritjen e nivelit te zhurmave merr parasysh faktori

“A” – niveli i presionit te zhurmes te llogaritur

Faktori « A » perbehet nga kontribuesit qe vijojne

Niveli i fuqise se zhurmes ne drejtim te perhapjes  $L_{ne\ drejtim\ te\ eres}$ , llogaritet per cdo burim

$$L_{ne\ drejtim\ te\ eres} = L_{W\_} - A$$

Ndikim te zhurmave do te kete gjate procesve te punes se prodhimit.

Niveli i zhurmave te ketyre makinerive, eshte i atij niveli qe nuk influencon si per te punesuarit dhe per banoret dhe gjallesat per rreth tij.

Niveli zhurmave nga puna e njekoheshme e makinerive ne distance 7 m nga to, eshte me i vogel se 70 dB. Duke mare parasysh shprehjen e nivelit te intensitetit akustik te nje zhurme me relacionin e me poshtem :

$$L = 10 \lg(I_1/I_0) \text{ ku}$$

$L$  - Niveli akustik i zhurmes te marre ne konsiderate .

$I_1$  - Intensiteti akustik i zhurmave

$I_0$  - Intensiteti akustik i references

Vleresojme se niveli akustik i zhurmes ne rruge eshte me i ulet se ai i zhurmes se nje makine qe kalon ne te, praktikisht ai eshte 40-50 dB qe i pergjigjet kushteve te nje bisede me ze normal.

Fenomene te tilla si vibracion, ndricim, nxehtesia jane te paperfillshme ne zhvillim te ketij aktiviteti ne kete objekt.

Problemet e gjenerimit te mbetjeve dhe administrimit te tyre jane minimale per aktivitetin te cilin po trajtojme. Mbetjet urbane qe krijohe nga aktiviteti i perditshem i personelit hidhen ne vendin e caktuar per kete qellim dhe me pas do largohen per ne vendin e caktuar.

Per te shmangur dhe menaxhuar sa me mire ndikimet negative ne mjedis te shkaktuara nga elementet e pershkruar me siper, subjekti nepermjet personelit te tij harton dhe zbaton nje plan efikas menaxhimi te ndikimit ne mjedis. Realizimi me sukses i ketij plani sjell nje sere perfitimesh per shoqerine te tilla si: ushtrimi i veprimtarise ne perputhje me ligjet dhe rregulloret, marrdhenie te mira me publikun dhe ambjentalistet, shmangia e penaliteteve nga organet e kontrollit te mjedisit etj.

Per te parandaluar efekte negative shoqeria ;

- Do te perzgjedh teknologji plotesisht te kontrolluar dhe moderne me pajtuesmeri mjedisore.

- Zbatim rigoroz i rregullave të sigurimit teknik gjatë punës dhe ndërprerjes së saj duke zbatuar normat e vendosura për këtë qëllim kur konstatohet shkelje.
- Përdorimi i mjeteve mbrojtëse në punë
- Në vendet të dukshme dhe me shkalë të lartë rrezikut të vendosën parulla paralajmëruese.
- Tokëzimi i të gjitha pajisjeve që punojnë me energji elektrike për të shmangur aksidente me pasoja

Nga ana e shoqërisë dhe stafit të saj do të kontrollohet:

- Pajisja me mjetet e duhura të mbrojtjes nga zjarri (MNZ)
- Sigurimi i të gjitha pajisjeve të nevojshme për riparim, pastrim dhe ndërhyrje në rast emergjencash.
- Sigurimi i ambalazhuesve të sigurt dhe rezistent për mbetjet (kazan, kova, kosha, qese etj).

Do të ketë ndërhyrje të menjehershme për riparimin e defekteve dhe avarive teknike, në rast zjarresh do të bëhet aktivizim i menjehershëm i stafit dhe mjeteve të fikjes së zjarrit si dhe njoftim i menjehershëm i autoriteteve dhe njesive të specializuara në rast emergjencash (zjarrfikës, autoambulanca).

Për të shmangur dhe menaxhuar sa më mirë ndikimet negative në mjedis të shkaktuara nga elementet e përkrahur me sipër, subjekti nëpërmjet personelit të tij harton dhe zbaton një plan efikas menaxhimi të ndikimit në mjedis. Në përpilimin e Planit të Menaxhimit dhe analizimit të tij është vërejtur se realizimi me sukses i këtij plani sjell një sërë përfitimesh për shoqërinë të tilla si: ushtrimi i veprimtarisë në përputhje me ligjet dhe rregulloret, mardhenie të mira me publikun dhe ambientalistët, shmangia e penalteteve nga organet e kontrollit të mjedisit etj.

#### **e) Informacion për kohezgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuara**

Gjatë fazës normale të operimit të projektit nuk do të ketë emetime të gazeve, lengjeve, mbetjeve toksike, helme të ndryshme dhe substanca të tjera të dëmshme, të cilat mund të ndikojnë negativisht në shëndetin e punonjësve, banorëve dhe mjedisin përreth, florën dhe faunën e zonës, burimet ujore. Mëqenëse nuk do të përdoren në procesin e prodhimit të betonit dhe fraksionimit lende të dëmshme, nuk do të ketë shkarkime të lendeve kimike të dëmshme për mjedisin në ajër, tokë dhe ujë. Sipërfaqja ku zhvillohet aktiviteti nuk është tokë bujqësore produktive. Ushtrimi i aktivitetit në këtë sipërfaqe nuk ndikon negativisht në cilësinë dhe sasinë e tokës bujqësore. Tokat bujqësore ndodhen jashtë zonës ku do të kryhet aktiviteti.

Përsa i përket ndikimit në peizazhin ekzistues dhe topografinë e saj do të zgjas për gjatë kohës së kryerjes së aktivitetit. Në rast mbyllje të këtij aktiviteti shoqëria do të bëjë instalimin e impiantit të prodhimit të betonit dhe zhvendosjen e frontos duke qenë se është portabel dhe përshatjen e sipërfaqes për zhvillimin e ndonjë aktiviteti tjetër duke qenë se sipërfaqja e tokës është në pronesi të shoqërisë.

**Te dhëna për shtrirjen e mundshme hapësimore të ndikimit negativ në mjedis, që nënkupton distancën fizike nga vendodhja e projektit dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të.**

Duke njohur teknologjinë, operacionet në terren dhe mënyrën e prodhimit të betonit dhe fraksionimit të inerteve u identifikuan ndikimet e mundshme negative në çdo receptore - përberës të mjedisit në objekt.

**Identifikimi i ndikimeve** – Përmes të cilit u përcaktua ndërveprimi mjedis-projekt i prodhimit të betonit dhe fraksionimit të inerteve dhe u identifikuan ndikimet e mundshme gjatë kësaj faze sipas receptoreve të mjedisit.

**Vleresimi i ndikimeve** – Ekspertet mjedisore te fushave te ndryshme bene perpjekje per matjen e gravitetit te ndikimeve. Vleresimi i Sinjifikances ka te beje me vete rendesine e ndikimeve dhe eshte faza me e rendesishme per zbatuesit e projektit sepse argumenton çdo ndikim negativ dhe perafrohet me objektivisht me teresine e bashkeveprimeve midis projektit dhe mjedisit. Kriteret e perdorur per vleresimin e rendesise se ndikimeve variojne dhe drejtohen kryesisht nga vlerat e mjedisit te ndikuar.

**Shtrirja fizike**- Vlereson siperfaqen apo dimesionin hapsinore te nje ndikimi te dhene ne raport me burimin qe gjeneron ate ndikim, p.sh. ndikimi ne toke nga instalimi i impiantit eshte nje ndikim saktesisht i percaktuar i cili mund te matet , por ne se do te ket erozion te tokes ndikimi rritet ne permasa fizike te siperfaqes se marre per studim.

- **Kohezgjatja e ndikimit** – Vlereson se sa do te zgjase nje ndikim i caktuar ne dimesionin kohe (ndikim i perhershem apo i perkoshem). Ne rastin tone impianti i betonit dhe fraksionimit te inerteve eshte e perhereshme per nje afat qe do vendoset nga administratori i shoqerise. Ndersa te gjitha ndikimet e tjera negative ne mjedis jane te perkoshme, si shkarkimet e ujit te rreshjeve, emetimet e pluhurave, etj

-**Kthyeshmeria** –Vlereson mundesin e kthimit te mjedisit te ndikuar ne gjendjen e tij te me pareshme (aftesia per tu rehabilituar dhe regjeneruar )

-**Rendesia** – Realizon nje vleresim total te tre permasave te mesiperme dhe njekoheisht thekson vemendjen qe duhet patur per administrimin e ndikimit.

Ndikimet e parashikuara nuk kane shtrirje te madhe fizike, objekti ndodhet ne distance te konsiderueshme nga zona me e afert e banuar dhe nuk preket nga zhvillimi i ketij aktiviteti. Zhurmat qe krijohen gjate fraksionimit nuk perbejn ndotje akustike. Analiza e frekuences te zhurmes te emetuar nga keto makineri dhe pajisje tregon se ato ndodhen nen mesataren e frekuences 100 – 150 Hz , e cila eshte e pranueshme nga veshi i njeriut . Koha ne te cilen do te jene te pranishme keto zhurma eshte vetem gjate dites, meqenese ne objekt do punohet vetem me nje turn. Niveli i zhurmave te ketyre mjeteve ne largesi nuk do te jete i madh dhe do te jete konform normave ne fuqi.

**f) Mundesine e rehabilitimit te mjedisit te ndikuar dhe mundesine e kthimit te siperfaqes te mjedisit te ndikuar ne gjendjen e meparshme, perfshire edhe token bujqesore , si dhe kostot financiare te peraferta per rehabilitimin**

Masat per rigjenerimin e mjedisit do te konsistojne ne:

- a. kryerjen e të gjitha punimeve të domosdoshme momentale rehabilituese, sipas projektit
- b. krijimin e sipërfaqeve me mbjellje.
- c. sistemimin e materialeve dhe të sterileve që vijnë nga kryerja e proceseve te punes, të planifikuara në projektin inxhinierik
- d. mbjelljen e siperfaqeve të gjelberuara e mirëmbajtjen e sipërfaqeve të mbjella, etj.

**a) Masat e mundshme per shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative ne mjedis**

Masat zbutese te ndikimeve negative konsistojne ne marrjen e masave per uljen e ndotjeve gjate procesit te prodhimit te betonit dhe fraksionimit te inerteve, si te pluhurit ne ajer, zhurmave, erozionet si dhe uljen e efekteve negative hapsinore ne territor , faune dhe flore.

### ***Masat ndaj erozionit***

Erozioni është një fenomen që rrezikon tokën ose burimin më të rëndësishëm mjedisor. Ai është një fenomen natyror që ka të bëjë me gërryerjen, zhvendosjen dhe transportin e lëndëve të ngurta ose materialit tokësor kryesisht nën forcën e veprimit të ujit, akullit ose erës. Erozioni vepron në kundërshti me ekuilibrin natyror të ekosistemeve. Në një këndvështrim të përgjithshëm, nevojitet një kohë shumë e gjatë për të kompensuar humbjen e lëndës të shkaktuar nga erozioni për një kohë fare të shkurtër. Disa nga faktorët që influencojnë erozionin janë : -sasia dhe intensiteti i reshjeve - kushtet e relievit (pjerrësia) dhe mënyra e përdorimit të tokës -degradimi i mbulesës bimore (ç'pyllëzimet, zjarret, mbikullotja etj) -modifikimi i topografisë (p.sh. ndertimi i rrugëve, qendrave urbane etj) - politika e administrimit të ujrave (kanalizimet, veprat hidrike, pritrat, etj) Masat e luftës kundër erozionit synojnë parandalimin e rreziqeve për mjedisin human ose konservimin e burimeve jetësore. Parandalimi dhe kufizimi i erozionit është i lidhur direkt me përmirësimin e kushteve të mjedisit dhe në afatgjatë ndikon drejtëpërdrejtë cilësinë e jetesës. Nje nga detyrat me te rendesishme , por edhe me te veshtira per mbrojtjen e tokave eshte lufta kunder erozionit , nga i cili cdo vit demtohen mijera ha toke bujqesore. Dihet se intensiteti i erozionit varet nga faktoret fiziko- gjeografike si perberja litologjike , relievi (kryesisht pjerrësia e tij), kushtet klimatike , shkalla e mbuleses me bimesi dhe tipi i saj dhe nga veprimtaria prodhuese e njeriut.

Kjo zone nuk ka predispozim te theksuar per erozion ne siperfaqen e tokes, ky fenomen eshte ne nivele te paperfillshme. Per shmangien dhe parandalimin e erozionit te zones ku eshte instaluar impianti i prodhimit te betonit dhe frontos fraksionimit te inerteve rrethinave perreth si dhe per ruajtjen e regjimit te rrymes se ujit te reshjeve dhe parametrave hidrodinamike te saj, ne projekt eshte percaktuar shfrytëzimi harmonik dhe i kombinuar ne kohe dhe hapësire i zones ne teresi.

Ne zonen ku zhvillohet projekti hap pas hapi dhe ne perfundim te aktivitetit, eshte parashikuar sistemimi dhe mbulimi i nje siperfaqeje te konsiderueshme me dhera humusore dhe bimesi te zones.

Kjo siperfaqe e perftuar nga trajtimet e mesiperme, do te jape mundesi per kultivimin e bimeve dhe pemeve te ndryshme, duke krijuar njeheresh kushte per parandalimin e eriozionit dhe permiresimin e pamjes se pergjithshme te zones ku do ushtrohet aktiviteti.

### ***Masat per emetimet ne ajer***

Aktiviteti I impiantit te prodhimit te betonit dhe te fraksionimit te inerteve, rikuperimit te mbetjeve inerte dhe grumbullimit e ruajtjes se perkohshme te tyre nuk sjell emetime te gazeve ne atmosfere sepse nuk perdore lende djegese gjate zhvillimit te aktivitetit te tij prodhues.

Lenda djegese perdoret vetem nga mjetet e transportit te lendeve te para si dhe produktit perfundimtar. Per mbrojtjen nga gazet e motorreve diezel do te merren keto masa :

- 1- Mjetet motorrike do te jene bashkekohore qe plotesojne standartet shteterore.
- 2- Ato do te jene te pajisura ne marmita me katalizatore per kapjen e gazeve toksike.

Persa i perket pluhurave qe krijohen gjate procesit te ngarkimit apo shkarkimit te lendeve te para /mbetjeve inerte nga ana e shoqerise ne menyre periodike sidomos ne kohe te thate do te behet lagia e territorit me uje per shmangien e pluhurit.

Perreth linjes do te behet sistemimi i ambientit per qellim mbrojtjen e peizazhit duke bere mbjelljen e pemeve me gjelberim te perhershem si dhe me lule dekorative. Nga ana e personelit te shoqerise do te tregohet nje kujdes i vecante per mirembajtjen e tyre.

### ***Masat per uljen ne minimum te zhurmave***

Burim zhurme është çdo makinë, instalim, mjet pune, mjet transporti, proces teknologjik, që lëshon zhurmë. Mbrojtja nga zhurma per zhvillimin e ketij aktiviteti duhet te sigurohet nga vet shoqeria aktiviteti te ciles e gjeneron ate. Masat e mbrojtjes nga zhurma përbëjnë tërësinë e ndërhyrjeve dhe të veprimeve, që merren ndaj burimit të zhurmës, si dhe në vendin e ndikimit të saj negativ, duke e sjellë atë në nivelin kufi.

Masat qe do te merren per minimizimin e zhurmave nga ana e shoqerise jane:

- Makinat e transportit dhe pajisjet gjate fazes funksionimit do te jene bashkekohore qe plotesojne standartet shteterore, te pajisura ne marmita silenciatore te pakesimit te zhurmave.
- Per te ulur me tej ndikimin nga zhurmat punetoret detyrimisht do te perdorin paisjet e mbrojtjes ne pune “kufje”

### ***Masat per Shkarkimet ne uje***

Sic eshte theksuar edhe me siper ky proces nuk shkarkon ne mjedis uhor prites ujera te ndotura nga procesi i prodhimit te betonit dhe fraksionimit te inerteve.

Praktikisht eshet ndertuar nje vaske dekantimi me keto parametra: gjatesi 6 m, gjeresi 3 m dhe thellesi 2 m. ujerat e shiut dhe uji qe perdoret per sperkatje do te shkarkohet ne kete vaske dhe pasi dekantojne shkarkohen ne rrjetin e zones. Ujrat largohen nga vaska pasi te jene ngurtesuar masa e ngurte inerte dhe depozitohen ne sheshin e caktuar . nje pjese e ujerave te pastra pas vaskes do te riperdoret per lagien e territorit per eleminin e pluhurave. Ne menyre periodike nga ana e shoqerise do te behet pastrimi i kanaleve orientues si dhe vaskes se dekantimit.

### ***Masat per Depozitimet ne toke***

Sheshi i ndertimit nuk ka aspak vegjetacion. Nuk do te jete nevoja per levizje volumesh te medha dherash, pasi terreni eshte relativisht i sheshte dhe aktiviteti i impiantit te betonit eshte ekzistues, ndersa instalimi i frontos per fraksionim nuk kerkon germime pasi frontoja eshet portable dhe thjehst inkastrohet ne siperfaqe.

Gjate procesit te funksionimit ky aktivitet nuk gjeneron mbetje te ngurta ne forme sterileshe te demshem per mjedisin, inertet te cilat nuk arrijn te fraksionohen rifuten ne proces fraksionimi. Mbetje te tjera te cilat dalin nga aktiviteti i perditshem i punetoreve do grumbullohen ne kontenier dhe me pas largohen per ne vendin e caktuar nga pushteti lokal i zones konform kërkesave të përcaktuara. Persa i perket sterileve te cilat dalin nga pastrimi i vaskave te dekantimit depozitohen ne vendin e vecante te percaktuar nga shoqeria.

### ***Masat estetike dhe ekologjike***

Në projektin e impianteve do te merren masat estetike dhe ekologjike te cilat konsistojne ne rregullimin e ambjentit te jashtem me lule dekorative per te krijuar nje ambjent te kenaqshem per syrin e njeriut.

### **Rastet aksidentale**

Zbatimi i ketij projekti nuk do te sjell rrezikshmeri per aksidente, duke qen se nuk do te kete mbajtje ose perdorim i substancave te rrezikshme. Jane marr masat per parandalimin e tyre, mjetet kontrollohen vazhdimisht per gjendjen teknike te tyre ne menyre qe te mos kemi rrjedhje lubrikante apo karburant. Shoqeria siguron se do kete nderhyrje te menjehershme nese do te kete ndikime negative ne mjedis.

### **Rreziqet me pasoja ne mjedisin human dhe ekonomik**

- Aksidentet e punonjesve gjate procesit teknik ne objekt.
- Aksidentet si pasoje e renes se zjarrit.

Probabiliteti i ndodhjes per secilin nga rastet e me siperm do te varet shume nga masat mbrojtese qe do te parashikohen dhe zbatohen. Zhvillimi i aktivitetit nuk shoqerohet me aksidente te cilat mund te sjellin pasoja te demshme ne mjedis si ndotje te ujerave nga lende te rrezikshme, emetime ne ajer nga gaze helmuese apo kontaminim te tokes.

### **Sigurimi teknik dhe mbrojtja ne pune**

Aktiviteti nuk perdor lende te demshme dhe te rrezikshme si per mjedisin ashtu edhe per punonjesit. Per shmangien e aksidenteve nga pajisjet dhe makinerit tregohet nje kujdes i vecante nga punonjesit per mirembajtjen e gjendjes se tyre teknike si dhe zbatohen me rigorozitet kushtet e sigurimit teknik. Gjithashtu ne menyre periodike punonjesit instruktohen per rreziqet ne pune dhe masat e menytrat per parandalimin e tyre.

Per te krijuar nje ambjent pune optimal dhe funksional shoqeria do te pajise te gjithë punonjesit qe do te punojne ne impiantin e fraksionimit dhe mjetet mbrojtese perkatese.

Regulloret e Teknikes se Sigurimit, nga ana e drejtuesit teknik dhe shoqerise , do te zbatohen ne cdo proces pune te percaktuar ne plan- organizimin e kryerjes se proceseve te punes te hartuar nga drejtuesi teknik i punimeve dhe te miratuar nga drejtuesit e shoqerise , i cili do te permbaje

- Plan organizimi i punes hartohet nga drejtuesi teknik
- Drejtuesi teknik i punimeve, ose personi i ngarkuar, do te beje kontrollin teknik per ecurine dhe mbarevajtjen sa me te mire te proceseve te punes.
- Drejtuesi teknik i punimeve do te kryeje instruktme te rregullta mujore e tre mujore per punonjesit.
- Kujdes i vecante do te tregohet ne krijimin e kushteve te punes sa me konforte per punonjesit.

### **Masat ndaj zjarrit**

Rreziku ndaj zjarrit eshte prezent ne te gjitha mjediset, zjarri eshte nje djegie qe zhvillohet ne menyre te pakontrolluar ne kohe dhe hapësire , pra eshte nje reaksion kimik ndermjet nje trupi te djegshem dhe nje trupi qe djeg. Per te ulur shkallen e rrezikut ndaj zjarrit dhe sigurimin e mbrojtjen e personave nga ana e shoqerise do te merren masat ndaj mbrojtjes se zjarrit. Hidrantet do te vendosen ne zona te dukshme dhe punonjesit do te instruktohen per perdorimin e tyre ne raste aksidentesh. Punëdhënësi pas vlerësimit të rreziqeve të zjarrit dhe në bazë të planit të emergjencës, i përcakton punëtorët përgjegjës për zbatimin e masave të parandalimit të zjarrit, luftën kundër zjarrit dhe menaxhimit të emergjencave. Detyra e përgjegjës është, jo vetëm të sigurojë që puna të kryhet në bazë të programit, por edhe që ajo të kryhet në kushte sigurie, duke respektuar masat e vëna në dispozicion nga eprorët, rregullat mbi kujdesin në punë, si dhe duke pretenduar që

punëtorët të respektojnë standartet dhe të përdorin, nëse nevojitet, pajisje personale mbrojtëse si dhe të kontrollojnë funksionimin e tyre. Ne raste zjarresh do të behet aktivizim i menjehershëm i stafit dhe mjeteve të fikjes së zjarrit si dhe njoftim i menjehershëm i autoriteteve dhe njesive të specializuara në rast emergjencash (zjarrfikës, autoambulanca). Rruget hyrëse në impiant janë projektuar në mënyrë të tillë që ka lehtësi për hyrjen e njesive të specializuara në rastet emergjente nga rruga dytësore « Iliria », Kashar buze të ciles zhvillohet dhe aktiviteti.

**I) Ndikimet me natyrë nderkufitare ( nëse projekti ka natyrë të tillë).**

Zhvillimi i aktivitetit nuk ka ndikime me natyrë nderkufitare, zhvillohet në Autostradë Tr-Dr, Km 6, Rr. Dytësore "Iliria", zona kadastrale nr.2105, Kashar, Tiranë.